



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER SAIMIR SHATKU
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR. 2, RR. HOXHA TASIM, GODINA
40/5, AP. 2
TEL: +355672557851

PËRPILIM DHE VËRTETIM TË SH.P.K.-VE

(AKT THEMELI DHE STATUT)

Nr. repertori: 1110

Nr. koleksioni: 507

Tirane më 10/09/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2020054190048193476





**AKTI THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Central Pharma Group" SH.P.K**

Sot, para meje Noter SAIMIR SHATKU, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA ADMINISTRATIVE NR. 2, RR. HOXHA TASIM, GODINA 40/5, AP. 2, u paraqit personalisht:

THEMELUES/IT:

Qamil Dika, atësia Hysen, amësia Bedrije, shtetas Shqiptar, lindur në Gjergjan, Elbasan dhe banues në TIRANË, me adresë IDRIZ DOLLAKU; Nd. 2; H. 12; Ap. 1; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 1; NJËSIA BASHKIAKE NR. 1; 1004; TIRANË, lindur më 26/06/1985, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031396330 dhe nr. personal I50626085E.

KREU I

Dispozita te Pergjithshme

KREU I-re

**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATIA, SELIA
NENI 1.**

Data e themelimit, Emri, Themeluesi

1. Sot me date 10/09/2020 une ortaku themelues krijoj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "Central Pharma Group" SH.P.K. Kjo shoqeri eshte themeluar sipas Aktit te Themelimit, bazuar ne legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe ne pershtatje te ketij Statuti te perpiluar dhe nenshkruar nga Ortaku themelues.
2. Themeluesi eshte QAMIL DIKA, atesia Hysen, i datelindjes. 26. 06.1985 lindur ne Gjergjan Elbasan dhe banues ne Elbasan, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga letenjoftimi ID me nr. Personal: **I50626085E**.

Kjo shoqeri bazuar ne Ligjin Nr. 9901 dt.14/04/2008 i ndryshuar, "Per Shoqerite Tregtare", per te ushtruar veprimtari sipas parashikimeve te bera ne kete Statut dhe legjislacionin ne fuqi.

Emertimi i shoqerise eshte "Central Pharma Group" SH.P.K. Shoqeria e percaktuar ne nenin 1 te ketij statuti eshte krijuar me mjetet ne pronesi private te Ortakut themelues te saj. Ajo regullon poziten juridike te themeluesit dhe punonjesve ne shoqeri, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise.

Shoqeria ka vulen e saj ne forme te zakonshme me stemen identifikuese te kompanise.

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e saj duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe te rentabilitetit.

NENI 2.

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

1- Hapjen, zhvillimin, menaxhimin dhe kryerjen e aktiviteteve ne fushen e shendetesise (mjekesi; parafarmaceutike; farmaceutike; optike, higjenizim, distribuim te medikamenteve, materialemeve mjekesore, integrotoreve ushqimore, bimeve medicinale dhe cdo lloj artikulli ne fushat e shendetesise, stomatologji; sherbime diagnostikuese mbeshtetese etj).

2- Import – eksport dhe tregeti me pakice dhe me shumice të artikujve dhe mallrave parafarmaceutike, farmaceutike, higjenosanitare, optike, dentare, kozmetike, veterinare,



hqimore, dietike, lende të para apo produkte dhe mallara të licencuara nga organet e tjera kompetente në rastet kur kërkohet. etj.

3- Tregtim artikuj për fëmijë si ushqyes, shtesa ushqimore, biberonë ushqyes, shishe biberoni, lodra për fëmijë etj.

4- Import-eksport pajisjesh mjekësore, reagentëve dhe kiteve, servis pajisjesh mjekësore dhe mirëmbajtje.

5- Çdo aktivitet ndihmës në përputhje me legjislacionin shqiptar i cili i shërben aktivitetit të saj kryesor.

6- Veprimtari ne fushen e arsimit parauniversitar dhe universitar mbi edukimin shendetesor.

7- Veprimtari ne turizmin mjekesor, rezervimin, kontraktimin e sherbimeve shendetesore per te trete.

8- Ofrimin e sherbimit te konsulencës teknike, marketingut ne veprimtarise se bizneseve ne fushen e shendetesise, hapjen e linjave te prodhimi farmaceutike etj.

9- Ngritje klinikash mjekësore të specializuara ose të përgjithshme dhe shfrytëzimi i tyre, fabrikimi dhe tregtimi i produkteve të lartëpërmendura, konsulencë teknike, dhe sipërmarrje marketingu në fushën e shëndetësisë, organizimi i kurseve të trajnimit dhe edukimit afatshkurtër dhe afatgjatë për fushën e shëndetësisë,

10- Dhënie në përdorim dhe me qera të aparaturave, etj.

11- Te kryeje investime ne sektorin publik ne fusha te ndryshme sherbimi dhe prodhimi.

12- Veprimtari ne turizem, hoteleri, sherbime restoranti, bar kafe, agroturizem, agrobiznes etj.

13- Aktivitete ne fushen e turizmit si guidat turistike, paketave turistike. Promovimin e vlerave e trashegimise kulturore dhe traditave te zones ku shtrin veprimtarine shoqeria.

14- Kultivim dhe prodhim te kulturave bujqesore, blegtorale, bletarise, bimeve medicinale etj. Ruajtja, konservimi, perpunimi, ekspozimi, trajtimi shitja me pakice dhe shumice e tyre brenda dhe jashte vendit.

15- Krijim, menaxhim dhe zhvillim te sherbimeve ne aktivitete si bar, restorant, catering, bujtina, hoteleri, plazhit etj.

16- Krijim, menaxhim dhe zhvillim te fermave bujqesore.

17- Organizimin e panaireve ne fushat e veprimtarise se shoqerise.

18- Qender e shendetit mendor dhe fizik.

19- Import eksport i produkteve bujqesore, blegtorale si dhe produkteve, materialeve, pajisjeve dhe sherbimeve ne fushen e bujqesise, blegtorise, arsimit, shendetesise etj.

20- Konsulenca, trajnime, analiza, raporte, ngritje kapacitetesh per institucione dhe organizata per fushat e veprimtarise se shoqerise.

21- Botime te teksteve, librave dhe veprimtarive te tjera ne fushen e edukimit parauniversitar dhe universitar si dhe te ofrimit te edukimit alternative.

22- Ofrimin e veprimtarise ne arsimin profesional.

NENI 3.

Selia

Shoqeria do te kete Seline e saj ne Tirane prane Rruges se Kosovareve prane Diges se Liqenit.

Ajo mund te çele filiale, dege dhe perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise, ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj me vendim te Asamblese se Ortakeve (ortakut te vetem).

NENI 4

Kohezgjatja

“Central Pharma Group” SH.P.K. eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe ka nje kohezgjatje duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB dhe eshte e pakufizuar.

NENI 5.

Shoqeria pergjigjet per detyrimet e saj me fondet e veta.

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Kapitali themeltar i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “ Central Pharma Group” SH.P.K. eshte 100. 000



(njqindmije lek). Ky kapital eshte teresisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortakut i vetem i shoqerise. Shoqeria mund te shtoje ose pakesoje kapitalin e saj deri ne limitin e percaktuar me ligj, me vendim te Asamblese se Ortakeve (ortakut te vetem).

Kapitali themeltar perbehet nga kontributi i meposhtem: 100. 000 (njqindmije lek) ose 100% te kapitalit themeltar:

KREU II-te

Te drejttat dhe detyrat e Ortakut themelues:

NENI 7

Ortakut gezon keto te drejttat kryesore:

Pjesmarrjen ne rezultatet e cdo forme dhe sasie te veprimtarise se shoqerise e parashikuar ne kontraten dhe statutin e saj.

Marrjen e te gjitha te dhenave qe kane te bejne me gjendjen ekonomike tregtare dhe veprimtarine e shoqerise, si dhe me te gjitha dokumentat e perpunuara nga shoqeria, bilancet si dhe llogarite ekonomike, etj.

Te heqi dore nga shoqeria.

Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise.

Te marri pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen nepermjet perfaqesuesve te tije ose vete.

Te kerkoje t'i jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen prodhuese dhe tregtare te shoqerise, si dhe te gjitha dokumentat e perpunuara te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj.

Te beje propozime dhe t'i paraqesi ato per shqyrtim para organeve te shoqerise.

Te emeroje dhe te shkarkojne perfaqesuesit e saj, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuidatoret.

Ortakut ka keto detyrime kryesore:

NENI 8

Te depozitoje kuoten e tij dhe kuotat suplementare ne perputhje me kontraten dhe statutin.

Te marrin pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga vete ai.

T'i japin shoqerise te dhenat e domosdoshme per perpunimin e cdo objekti te vecante lidhur me veprimtarine e saj.

Te kryeje detyrat per realizimin e objektivave dhe te funksioneve te shoqerise.

Ti japin shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj.

Te kryejne sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.

Pjesemarrja ne shoqeri nuk e pengon ortakun te kete pavaresi ligjore per veprimtari te tjera dhe per te drejttat te tjera pronesie. Ata nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise qe rrjedhin nga objekti i veprimtarise se saj te kapitalit themelor ku ata kane marre pjese.

KREU III-te

Kushtet Ekonomike

NENI 9

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te leverdise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancet e saj.

Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 Marsit te vitit pasardhes. Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

NENI 10

Llogarite vjetore inventari, raportet operacionet e veprimtarise se vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga Ortakut themelues. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

NENI 11

Per te bere te mundur zhvillimin e veprimtarise se shoqerise, vihet nje kapital baze qe perben burimin fillestar per krijimin e fondit themelor dhe te mjeteve te xhiros.

NENI 12

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100'000 lekë (njqind mije) i formuar ne mase te plotë nga kontributet e ortakëve dhe i ndare ne 1 kuote me vlerë nominale sipas ndarjes me poshte. Cdo kuote njësie ka te drejttën



e (1) një vote. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre si më poshtë:

Ortaku themelues Z. Qamil Dika: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100'000 lekë (njqind mijë) që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 13.

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të ardhurave i merr ortaku themelues.

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, mbasi zbriten të gjitha detyrimet si edhe fondet e lena rezerve për nxitjen ekonomike, për investime, për reklamen tregtare etj. përfitohej prej ortaku themelues të kësaj shoqërie.

Ortakët përballojnë humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së tyre të derdhur në formimin e kapitalit themeltar. Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit të tij ortaku ka të drejtën e rritjes së tij. Pjesët e kapitalit themeltar janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie në rast ndarje pasurie ndërmjet bashkeshortëve dhe nëpërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vertetohet me akt noterial.

Shoqëria në emër të vet është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurive të saj, por gjithmone në përputhje me qëllimin e objektit e veprimtarisë që ajo kryen.

Shoqëria mund të shesë pasuri ose të shfrytëzojë të drejtat e tjera materiale. Ajo mund të ofrojë për garanci edhe pasuri të saj për të marrë kredi bankare.

Shoqëria krijon fonde rezerve ose dhe fonde të tjera të vecanta për zhvillimin dhe nxitjen ekonomike të saj.

NENI 14.

Shoqëria është pronare e pasurive të saj dhe ka të drejtë të përdorimit dhe disponimit të kësaj pasurie, në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë që kryen. Shoqëria gëzon të drejtat për mbrojtjen e pasurisë së saj në përputhje me legjislacionin shqiptar ose atë ndërkombëtar nëse është e nevojshme.

NENI 15.

E ardhura bruto e shoqërisë, pasi zbritet amortizimi i të gjithë pasurisë së lujtshme e të palujtshme, sipas afateve të caktuara, kuotat që kanë të bëjnë me kredite për investimet, pagat e shtesat mbi pagat, shpenzimet për lëndet e para apo ndihmëse e energjinë si dhe shpenzimet e përgjithshme të saksioneve të shoqërisë dhe ato për qëllime të tjera prodhuese e joprodhuese, i takojnë ortakëve të shoqërisë.

KREU IV-te

Administrimi

NENI 16

Ortaku themelues merr vendime për çdo aspekt të veprimtarisë së shoqërisë

Kompetencat ekzekutive të Ortakut themelues të shoqërisë janë:

1. Përcaktimi i të drejtave kryesore të veprimtarisë së shoqërisë.
2. Ndryshimet në emertesen e prodhimit që do të realizohet dhe të punimeve që do të kryhen, që janë pjesë perberese e objektit të veprimtarisë së shoqërisë.
3. Vendimet e nevojshme për ndryshimet në kapitalin baze të shoqërisë.
4. Përcaktimi i regjimit dhe i kushteve të zbatimit të parimeve të llogarive ekonomike.
5. Përcaktimi i rregullave dhe i normave, që perkufizojnë raportet me gjirin e shoqërisë, duke përfshirë edhe kuadrin e personelit.
6. Përcaktimi i strukturës së aparatit të shoqërisë.
7. Përcaktimi i organikes dhe ndarja e vendeve drejtuese ndërmjet perfaqësive të ortakëve.
8. Emertimi dhe zëvendësimi i Administratorit të përgjithshëm të shoqërisë.
9. Krijimi i organeve të tjera të domodoshëm për realizimin e objektivave të shoqërisë.
10. Përcaktimi i madhësisë së kuotave për formimin e kapitalit baze të shoqërisë.
11. Paraqitja e propozimeve për rregullimin, krijimin dhe përfitimin nga fondet e vecanta, ndarjen e fitimeve dhe përcaktimi i rregullave për shlyerjen e borxheve.
12. Marrja e vendimit për krijimin e filialeve të degeve e të perfaqësive si dhe për cedimin e veprimtarisë së tyre.
13. Përcaktimi i rregulloreve për procedurën e punës të administratës.
14. Pergatitja e propozimit për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë.
15. Perzgjedhja, emërimi dhe revokimi i anëtarëve për komisionin e likuidimit.
16. Kryerjen e veprimtarive për likuidimin e llogarive, që i perkasin ortakut dorëheqës të shoqërisë.
17. Marrjen e vendimit për kerkimin dhe përdorimin e kredive afatgjata.



NENI 17

Veprimtaria operative e shoqerise drejtohet nga Administratori i saj.
Ne shoqerine "Central Pharma Group" SH.P.K Administrator i shoqerise do te jete, **Z. Qamil DIKA me nje afat 5-vjecar**, i cili ne te njejten kohe ka edhe funksionin e perfaqesimit te shoqerise me te tretet ne gjithë veprimtarine e saj. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet me interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh. Administratoret jane pergjegjes individualisht ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faj te tij gjate administrimit te shoqerise.

Kompetencat e administratoreve ne shoqeri jane:

- Te miratoje planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre ne kuadrin e veprimtarise se shoqerise.
- Te miratoje akte normative qe percaktojne raportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin dhe personelin.
- Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqerise.
- Te krijojë organe te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te shoqerise.
- Te perzgjedhi ekspertet kontabel dhe anetaret e komisionit te likujdimit.
- Te percaktoje numrin e punonjesve te shoqerise dhe pagat e tyre.
- Organizon punen per realizimin e planeve te shoqerise dhe raporton per to ne perputhje me programet e planet e pergjithshme, administron pasurine e shoqerise; duke perfshire ketu mjetet financiare.
- Drejton e kontrollon veprimtarine e filialeve te degeve e te perfaqesive nese ka shoqeria.
- Perfaqson shoqerine perpara te treteve si gjykate, etj.
- Nenshkruan kontrata ne emer e per llogari te shoqerise dhe siguron venien e tyre ne jete.
- Merr te gjitha vendimet qe kane te bejne me ato veprimtari te shoqerise, qe nuk jane ne kompetence ekzekutive te Ortakut themelues.
- Perfaqeson shoqerine ne lidhje me te tretet brenda caqeve te objektit te veprimtarise se saj, pervec ceshtjeve qe kerkojne unanimitetin e ortakeve ose qe kane te bejne me kompetencat qe ky statut i atribuon Asamblese se Ortakut.
- Ben hapjen e leter kredive ne leke e ne valute te huaj.

NENI 18.

Mardheniet e punes ne shoqeri.

Marrdheniet e punes ne shoqeri e filiale, ne dege e perfaqesite rregullohen ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqerise, legjislacionit shqiptar dhe me kete statut si dhe nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen ne kontraten e punes, zbatohen dispozitat e legjislacionit te punes. Punesimi i punonjesve ne shoqeri behet mbi bazen e kontrates kolektive dhe individuale te punes.

Ne kontraten e punes rregullohen keto ceshtje:

Kushtet dhe menyra e marredhenies se punes.

Fillimi i punes se punonjesve dhe caktimi i tij ne vendin e punes.

Koha e punes dhe caktimi i kohes se punes, puna e nates, puna jashte kohes normale, puna ne ditet e pushimit javor, festave zyrtare.

Mbrojtja ne pune dhe kushtet e punes.

Pushimet dhe mungesat, te drejtat, detyrimet dhe pergjegjesite e

Punonjesve per zbatimin e detyrave te punes.

Pushimi i marredhenies se punes.

Paga e punes se punonjesit, shperblimi i punes dhe shperblime te tjera.

Shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve prane saj ne organet perkatese duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Per te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte Gjykata e shkalles se pare gjyqesore.

KREU V-te

Mbyllja e Shoqerise:

NENI 19.



Veprimtaria e shoqërisë pushon me propozimin të ortakut, kur gjatë tre vjetëve nuk rezultojnë rentabel ose kur ortakut heq dorë nga shoqëria si dhe të gjitha rastet që parashikohen në dokumentet e krijimit të shoqërisë (kontrata). Shoqëria shpërndahet në formë riorganizimi ose likuidimi.
Afati i veprimtarisë së shoqërisë është – pa afat.

NENI 20.

Kur shoqëria likuidohet:

Ortakut themelues emëron likuidatorin, të cilit i paraqitet bilanci dhe shoqëria i jep fund veprimtarisë së saj në rastin e miratimit të këtij raporti të hartuar.
Pasurite që janë në dispozicion të shoqërisë me të drejtë shfrytëzimi, shiten në vartësi të shkallës së konsumit të tyre. Të ardhurat i takojnë ortakut themelues.

NENI 21.

Te Ndryshme

- 19.1** Cdo dokument që leshohet për dhe në emër të shoqërisë është i pavlefshëm nëse nuk mban vlerë në saj.
- 19.2** Të gjitha marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen me Kodin e Punës dhe cdo akt tjetër ligjor dhe nenligjor të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, në fuqi dhe në veprim kohe pas kohe gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit të saj tregtar.
- 19.3** Viti financiar zgjat 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 19.4** Në fund të cdo viti financiar, Administratori harton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, të cilin i dërgohet për miratim Ortakut themelues.
- 19.5** Për të gjitha çështjet që nuk janë parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në fuqi, të azhurnuar.

NENI 22

Dispozita përfundimtare

- 20.1** Ky statut përben dokumentin e vetëm të shoqërisë që parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarisë së shoqërisë. Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose tërësisht dhe të zëvendësohet me një statut të ri vetëm me vendim të Ortakut themelues.
- 20.2** Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, ortakut themelues do të referohet legjislacionit tregtar Shqiptar në fuqi si dhe praktikave tregtare në vend.

Ky statut u redaktua në 4 ekzemplare, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën Shqip dhe u nënshkrua nga ortakut themelues pa asnjë rezervë.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Unë Noteri verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

THEMELUES/IT

Qamil Dika

Qamil Dika
Q.D.

NOTER
SAIMIR SHATKU

Saimir Shatku
S. Shatku